

VENDIM
Nr.2, datë 29.1.2009

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Fehmi Abdiu	Anëtar i	“	“
Kujtim Puto	Anëtar i	“	“
Petrit Plloçi	Anëtar i	“	“
Sokol Sadushi	Anëtar i	“	“
Sokol Berberi	Anëtar i	“	“
Xhezair Zaganjori	Anëtar i	“	“

me sekretare Blerina Çinari, në datë 28.01.2009, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen me nr.38/23 Akti, që i përket:

KËRKUES:FATOS SHARKA, në mungesë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

KËSHILLI I MINISTRAVE, përfaqësuar nga zj.Marsida Xhaferllari, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimit nr.1583, datë 03.12.2008 të Këshillit të Ministrave “Për shkarkimin nga detyra të kryetarit të komunës Ballagat”.

GYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Xhezair Zaganjori, përfaqësuesin e subjektit të interesuar, që kërkoi rrëzimin e kërkesës, si dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Kërkuesi, në zgjedhjet e pjesshme vendore të vitit 2007, është rizgjedhur kryetar i komunës Ballagat në rrethin e Lushnjës. Me vendimin nr.181, datë 21.11.2007 të Gjykatës së Rrethit Lushnjë është dënuar me 2 muaj burgim dhe 300 000 lekë gjobë për veprën penale të shpërdorimit të detyrës. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr.163, datë 4.7.2008, i cili ka marrë formë të prerë. Kërkuesi, në datë 3.10.2008, në bazë të nenit 450 shkronja (c) të KPP, ka bërë kërkesë për rishikim në Gjykatën e Lartë me pretendimin se ka zbuluar fakte të reja për procesin e zhvilluar në ngarkim të tij. Kjo kërkesë ende nuk është marrë në shqyrtim nga ajo Gjykatë.

Kërkuesi parashtroi para Gjykatës Kushtetuese këto pretendime:

- kërkesa për rishikim e bërë prej tij në Gjykatën e Lartë duhet të kishte shërbyer si shkak që Këshilli i Ministrave të mos merrte në shqyrtim propozimin e bërë nga Ministri i Brendshëm për shkarkimin e tij.

- Gjykata Kushtetuese duhet të vendosë pezullimin e zbatimit të vendimit të Këshillit të Ministrave për shkarkimin e tij deri në shqyrtimin e kërkesës për rishikim.

Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, parashtron se kërkesa është e pabazuar dhe duhet rrëzuar, pasi:

- janë zbatuar të gjitha rregullimet kushtetuese dhe procedurale për shkarkimin e kryetarit të komunës, parashikuar nga neni 42 shkronja (b) e ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, të ndryshuar. Kërkuesi është dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata, gjë e cila përbën shkelje të rëndë të ligjit në kuptim të

nenit 115 të Kushtetutës;

- paraqitja e kërkesës për rishikim në Gjykatën e Lartë nuk përbën shkak për pezullimin e zbatimit të një vendimi penal të formës së prerë. Rishikimi i një vendimi penal është mjet i jashtëzakonshëm dhe vetëm nëse merr vendim Gjykata e Lartë mund të pezullohet ekzekutimi i tij.

II

Gjykata Kushtetuese, me datë 13.01.2009, hapi seancën për shqyrtimin e kërkesës së paraqitur nga kërkuesi. Gjatë paraqitjes së pretendimeve paraprake kërkuesi kërkoj nga Gjykata shtyrjen e seancës gjyqësore me pretendimin se kërkonte më shumë kohë për të siguruar mbrojtjen e tij, pasi, sipas tij, njoftimi për datën dhe orën e gjykimit i kishte mbërritur vetëm një ditë përpara.

Gjykata Kushtetuese, pasi shqyrtoi kërkesën paraprake, vendosi shtyrjen e seancës gjyqësore me datë 28.01.2009.

Në seancën e datës 28.01.2009, kërkuesi nuk u paraqit, por dërgoi një raport mjekësor sipas të cilit rezultonte të ishte i sëmurë dhe në pamundësi për të marrë pjesë në gjykim. Për këtë shkak, ai kërkoj sërish shtyrjen e seancës gjyqësore.

Nisur nga fakti se Gjykata Kushtetuese i la kohë të mjaftueshme në dispozicion kërkuetit për të siguruar mbrojtjen e tij para kësaj Gjykate, ajo vendosi të mos pranonte kërkesën për shtyrje të shqyrtimit gjyqësor dhe urdhëroi zhvillimin e saj në mungesë të kërkuetit.

III

1. Lidhur me pretendimin për shkelje të nenit 115 të Kushtetutës

Kërkuesi, me vendimin nr.1583, datë 3.12.2008 të Këshillit të Ministrave, është shkarkuar nga detyra e kryetarit të komunës Ballagat, në rrethin Lushnjë. Si bazë për marrjen e këtij vendimi ka shërbyer propozimi i Ministrit të Brendshëm nr.8350, datë 02.11.2008, drejtuar Këshillit të Ministrave. Propozimi është mbështetur në faktin se kërkuesi, me vendimin nr.181, datë 21.11.2007 të Gjykatës së Rrethit Lushnjë, është dënuar me 2 muaj burgim dhe 300 000 lekë gjobë për veprën penale të shpërdorimit të detyrës.

Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr.163, datë 4.7.2008. Mbi bazën e vendimit penal të formës së prerë, Këshilli i Ministrave, me vendimin nr.1583, datë 3.12.2008, ka vendosur shkarkimin e kërkuetit nga detyra e kryetarit të komunës.

Kërkuesi, në datë 3.10.2008, në bazë të nenit 450 germa (c) të KPP, ka paraqitur kërkesë për rishikim në Gjykatën e Lartë me pretendimin se ka zbuluar fakte të reja që lidhen me procesin penal të zhvilluar ndaj tij. Ky fakt, sipas tij, duhet të ishte i mjaftueshëm që Këshilli i Ministrave të mos vepronte deri në shqyrtimin e kërkesës për rishikim nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë.

Gjykata Kushtetuese vlerëson se kërkesa e paraqitur nga kërkuesi është e pabazuar dhe për këtë arsye duhet rrëzuar.

Neni 115/1 i Kushtetutës parashikon se organi i zgjedhur drejtpërdrejt i njësisë së qeverisjes vendore mund të shpërndahet ose të shkarkohet nga Këshilli i Ministrave për shkelje të rënda të Kushtetutës ose të ligjeve. Në frymën e kësaj dispozite, është miratuar ligji nr.8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, në nenin 42 të të cilit, parashikohen më hollësisht rastet e shkarkimit të kryetarit të komunës ose të bashkisë. Një nga këto raste është edhe rregullimi i pikës (b) të nenit 42, sipas të cilit kryetari i komunës ose i bashkisë shkarkohet me vendim të Këshillit të Ministrave kur dënohet për kryerjen e një veprë penale me vendim të formës së prerë nga gjykata.

Gjykata Kushtetuese vlerëson se kryerja e një veprë penale dhe dënimi me vendim të formës së prerë nga gjykata i një personi që ushtron një funksion publik, siç është ai i kryetarit të komunës, përbën shkelje të rëndë të ligjit në kuptim të nenit 115/1 të Kushtetutës. Ky fakt merr një vlerë të veçantë në rastin konkret, për arsye se vepra penale e kryer lidhet drejtpërdrejt me detyrën e ushtruar nga kërkuesi, gjë e cila bie ndesh me parimet e përgjithshme të ushtrimit të funksioneve publike në një shtet të së drejtës.

Për këtë arsye, Gjykata Kushtetuese çmon se Këshilli i Ministrave, i ndodhur para një

fakti të tillë, pra të dënimit të kërkuesit me vendim të formës së prerë nga gjykatat për veprën penale të shpërdorimit të detyrës, ka vepruar drejt duke vendosur shkarkimin nga detyra të kryetarit të komunës. Në këtë rast shkelja e rëndë e ligjit është vërtetuar nga gjykata, vendimi i së cilës ka shërbyer si bazë për shkarkimin nga detyra të kërkuesit.

Gjykata Kushtetuese e konsideron të pabazuar argumentin e kërkuesit se Këshilli i Ministrave nuk duhet të vepronte deri në marrjen në shqyrtim nga Gjykata e Lartë të kërkesës për rishikim. Rishikimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë, si penale ashtu edhe civile, është mjet i jashtëzakonshëm ankimi, i cili ushtrohet në rastet e parashikuara në ligjet procedurale penale dhe civile. Nenet 449 e në vijim të KPP parashikojnë rastet kur mund të kërkohej rishikimi i një vendimi penal të formës së prerë, si dhe kur Gjykata e Lartë mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të këtij vendimi. Gjykata, me kërkesën e palës, mund të pezullojë ekzekutimin e vendimit, kur vlerëson se ka rrezik të shkaktohet një dëm i madh dhe i pariparueshëm. Pra, thjesht fakti i bërjes së kërkesës për rishikim para Gjykatës së Lartë nga subjekti nuk passjell automatikisht pezullimin e ekzekutimit të vendimit. Kur Gjykata e Lartë, shqyrton kërkesën për rishikim dhe gjykon se mund të ketë rrethana të tilla që mund të hedhin dritë mbi vërtetësinë ose jo të fakteve mbi të cilat është marrë një vendim i formës së prerë, mund të urdhërojë pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor.

Gjykata Kushtetuese çmon se nuk ndodhet para një urdhërimi të tillë të Gjykatës së Lartë, prandaj Këshilli i Ministrave, duke vendosur shkarkimin e kërkuesit mbi bazën e vërtetimit të shkeljes së rëndë të ligjit me vendim penal të formës së prerë, ka vepruar në përputhje me kërkesat kushtetuese dhe ligjore.

Si përfundim, në vijim të arsyetimit të mësipërm, Gjykata Kushtetuese konstaton se pretendimi i kërkuesit se nuk janë respektuar kërkesat e ligjit dhe të Kushtetutës për shkarkimin e tij nga detyra e kryetarit të komunës Ballagat të rrethit Lushnjë, nuk është i bazuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 115 të Kushtetutës dhe 72 e vijues të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e shpalljes.

Anëtarë: Vladimir Kristo (kryetar), Fehmi Avdiu, Kujtim Puto, Sokol Sadushi, Petrit Plloçi, Xhezair Zaganjori, Sokol Berberi.